



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

Nr. 106, Datë 10 05. 2010.

**PËR BASHKËRENDIMIN E RAPORTEVE MES PROKURORIVE TË RRETHEVE
GJYQËSORE DHE PROKURORISË PËR KRIME TË RËNDA, NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 10 192, DATË 03.12.2009 "PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E
KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE TRAFIKIMIT NËPËRMJET MASAVE
PARANDALUESE KUNDËR PASURISË".**

Me qëllim zbatimin e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe koordinimin e veprimtarisë ndërmjet prokurorive të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë për Krime të Rënda,

në mbështetje të nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", (të ndryshuar):

U R D H Ë R O J:

1. Në çdo rast të regjistrimit të procedimeve penale për vepra penale të parashikuara nga nenet 114/a, 230/c, 230/ç, 283 dhe 287 të Kodit Penal, prokuroritë e rretheve gjyqësore fillojnë menjëherë verifikimin pasuror të subjekteve të parashikuara në nenin 3/2 të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".
2. Objekt i verifikimeve janë mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, niveli ekonomik si dhe burimet e të ardhurave të subjekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
Verifikimet kryhen në të gjitha institucionet shtetërore ose private duke përfshirë, por jo vetëm: Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tregtar, Qendrën Kombëtare të Liçensave, Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtorinë e Tatim-Taksave, Drejtorinë e Doganave, Agjensinë e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje.

3. Në përfundim të verifikimeve të kryera, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore që hetojnë veprat penale të cituara më sipër, duhet të dërgojnë pa vonesë një relacion shpjegues mbi faktet kriminale, verifikimet pasurore të kryera, subjektet përkatëse dhe rezultatet e këtyre verifikimeve. Relacionit i bashkëlidhen aktet që lidhen me:
- a. regjistrimin e procedimit penal;
 - b. regjistrimin e emrit;
 - c. njoftimin e akuzës nëse ka;
 - ç. të gjitha aktet që pasqyrojnë verifikimet pasurore.

Aktet duhet të jenë origjinale ose kopje të njësura me to.

4. Në rast të evidentimit të pasurive, të vlerësohet mundësia e kryerjes së sekuestrimit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe menjëherë të njoftohet Prokuroria për Krime të Rënda duke dërguar një relacion për çështjen sipas pikës 3 të këtij urdhëri.

- 4.1 Lidhur me llogaritë bankare, për të garantuar sekuestrimin në kohë dhe për të shmangur tjetërsimin apo humbjen e tyre, në çdo rast prokurori duhet të njoftojë urgjentisht Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, për të bërë bllokimin e depozitave bankare apo llogarive rrjedhëse të tyre. Kur është e mundur, procedohet me sekuestrimin e këtyre llogarive.

Në çdo rast që njoftohet Drejtoria e Pastrimit të parave apo bëhet sekuestrimi i llogarive të mësipërme, të njoftohet menjëherë Prokuroria Për Krime të Rënda së bashku me një relacion sipas pikës 3 të këtij urdhëri.

5. Prokurorët e Seksionit Pasuror në Prokurorinë për Krime të Rënda duhet të bashkërendojnë në çdo hetim pasuror veprimet e tyre me ato të prokurorive të rretheve gjyqësore apo prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda për veprat penale të parashikuara nga ky ligj, me qëllim grumbullimin e të gjithë të dhënave të nevojshme.
6. Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore informojnë në vijimësi dhe sa më parë Prokurorinë për Krime të Rënda për regjistrimin e personave të tjerë në kuadër të procedimeve objekt i këtij urdhëri, për informacione të tjera të grumbulluara gjatë hetimit dhe që lidhen me hetimin pasuror të personave, si dhe për ndryshimet e statusit të këtyre procedimeve.
7. Prokuroria për Krime të Rënda informon prokurorinë përkatëse të rrethit gjyqësor për çdo të dhënë që ajo ka grumbulluar gjatë hetimit pasuror në kuadër të ligjit të mësipërm dhe që gjykon se mund t'i shërbejë kësaj të fundit në hetimin penal të saj.
8. Zyrat e Prokurorisë, në hetimet dhe verifikimet pasurore, të angazhojnë edhe strukturat e posaçme të hetimit financiar të Policisë së Shtetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në Drejtoritë e Qarqeve.
9. Prokuroria për Krime të Rënda mban regjistër të veçantë lidhur me procedimet pasurore ku pasqyrohen të gjitha të dhënat nga momenti i ardhjes së informacionit deri në përfundimin e gjykimit për konfiskim, sipas formës që është mbajtur deri tani.

10. Në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të mbahet një regjistër i veçantë ku të evidentohen të gjitha rastet e njoftimeve që këto prokurori i kanë drejtuar Prokurorisë për Krime të Rënda për nisjen e hetimit pasuror në zbatim të këtij urdhëri.

10.1. Personi i ngarkuar me mbajtjen e regjistrit, në një dosje të veçantë mban një kopje të relacionit shpjegues që ka njoftuar Prokurorinë për Krime të Rënda si dhe çdo relacion tjetër në vijimësi, në kuptim të pikës 6 të këtij urdhëri.

11. Në rastet kur vendimet penale të gjykatave të huaja, për persona të dënuar për vepra penale objekt i Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, janë njohur me vendim gjyqësor të formës së prerë nga gjykatat shqiptare, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dërgon një kopje të këtij vendimi në Prokurorinë për Krime të Rënda, në funksion të kryerjes së hetimit pasuror.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM



Ina RAMA

